



AVOKATI I POPULLIT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
[.avokatipopullit.gov.al](http://avokatipopullit.gov.al)

Nr. 93 Prot.

Tiranë, 16 10B 2023

Lënda: Kërkesë për informacion në lidhje me kandidatët nga rradhët e avokatisë për Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë

Drejtuar: Z. Olsian ÇELA
Prokuror i Përgjithshëm

Tiranë

I nderuar z. Çela!

Avokati i Popullit në ushtrim të kompetencave të përcaktuara në ligjin nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, është duke zhvilluar procedurat që lidhen me verifikimin paraprak nga Komisioni i Pavarur Ad Hoc të plotësimit të kushteve ligjore, vlerësimin paraprak të kritereve profesionale dhe morale dhe renditjen e avokatëve që kandidojnë për të qenë anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

Ndër kompetencat specifike që i ngarkohen Avokatit të Popullit në cilësinë e kryetarit të Komisionit të Pavarur Ad-Hoc janë edhe kompetencat e renditura në pikën 2, 3 dhe 4 të nenit 31, si dhe në pikën 2, 3, 4, të nenit 129 të ligjit të sipërcituar.

Në zbatim të pikës 2 të nenit 31 dhe pikës 2 të nenit 129, ku përcaktohet se: "*Për kontrollin e integritetit të kandidatëve, kryetari i Komisionit i përcjell menjëherë Prokurorisë së Përgjithshme, formularët e vetëdeklarimit, të plotësuar nga kandidatët, sipas kërkesave të ligjit "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike". Prokuroria e Përgjithshme, kryen verifikimet brenda 30 ditëve nga paraqitja e formularëve". del e nevojshme që të verifikohet nga ana e institucionit tuaj përmbushja e kriterit ligjor, të përcaktuar në gërmën c, pika 3, të nenit 21, si dhe në gërmën c, pika 3, të nenit 119.*

Në këto dispozita citohet se: "Krahas kërkesës me shkrim, të interesuarit bashkëngjisin dokumentet e mëposhtme:

- *Formularin e vetëdeklarimit, sipas kërkesave të ligjit "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".*

Mbi bazën e formularëve të vetëdeklarimit të plotësuar nga kandidatet që kanë aplikuar nga rradhët e avokatisë për pozicionin e anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë, të cilët po i dergojmë bashkëngjitur kësaj shkrese, institucioni i Avokatit të Popullit kërkon bashkëpunimin tuaj për verifikimin sa më të shpejtë të formularëve përkatës.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin,

Me respekt,

AVOKATI I POPULLIT

Erinda Ballanca

NË MUNGESË DHE ME URDHËR

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Fatbardh Zenelaj



Emer Mbiemer
1. Adrian Leka
2. Alban Alimema
3. Albana Tushe
4. Altin Hazizaj
5. Altin Shegani
6. Andi Muratej
7. Artan Reçi
8. Bledar Bajri (Boshnjaku)
9. Daniel Ndrekaj (Ndoka)
10. Diana Dervishi
11. Donata Lepenica (Selmanaj)
12. Edison Hoxha
13. Eduard Allamani (Reçi)
14. Eduard Mullaraj
15. Emiljano Hajrulla
16. Entela Shehaj (Memishaj)
17. Erind Germenji
18. Erind Merkuri
19. Eris Hysi
20. Fatos Lazimi
21. Ilir Alushi
22. Juelda Lamce
23. Julian Kola
24. Klodian Gjermeni (Gjërmëni, Gjermëni)
25. Margarita Kola (Lena)
26. Mirela Murati (Aliçka)
27. Nada Dollani
28. Nertila Sadedini (Murati)
29. Perparim Kalo
30. Rezarta Abdiu
31. Saimir Vishaj
32. Saimir Kola
33. Sokol Dedndreaj
34. Valbona Greva
35. Violanda Theodhori (Dhonato)
36. Albens Tabaku
37. Petrit Gaci
38. Odise (Arben) Xhelita

